



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 201701449/2

Tiranë ___/___/2017

Lënda: *Rekomandim për inspektimin e kryer në Shtëpinë e të Moshuarve Gjirokastrër.*

Drejtuar: **Zj. ZAMIRA RAMA**
Kryetare e Bashkisë

G J I R O K A S T Ë R

Zj. Luneda SUFALI
Drejtore e Përgjithshme
Shërbimi Social Shtetëror

T I R A N Ë

Për dijeni: **Z. Aranit MUHO**
Drejtor i Shtëpisë së të Moshuarve

G J I R O K A S T Ë R

Të nderuara Zonja,

Avokati i Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut, më datë 07.11.2017, ka inspektuar Shtëpinë e të Moshuarve Gjirokastrër.

Ky inspektim u krye në mbështetje të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku parashikohet ndër të tjera se: "Avokati i Popullit ose persona të autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim apo autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në azile dhe vecanerisht në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër ku ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut".

"Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkesë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të

Popullit për qëllime inspektimi apo studimi. Avokati i Popullit në këto raste mund të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet apo mbahet në këto mjedise”.

Qëllimi i inspektimit ishte zbatimi i rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit në vitin 2015 si dhe vijimi i inspektimit.

Ju bëjmë më dije se më datë 16.11.2015 është kryer inspektim në Shtëpinë e të Moshuarve Gjirokastrë. Pas problemeve të konstatuara, i rekomanduam Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë dhe Drejtoreshës së Shërbimit Social Shtetëror, marrjen e masave për:

1. Shtimin në organikë me psikolog, mjek me kohë të plotë.
2. Shtim në organikë me roje objekti.
3. Vendosjen e një automjeti.
4. Funksionimin e ngrohjes qendrore.

Nga Shërbimi Social Shtetëror, me shkresën nr.97/1 datë 27.01.2016, lidhur me rekomandimet e sipërcituara, na informuan si më poshtë:

- **Për rekomandimin e parë dhe të katërt.** Institucioni është nën administrimin e Bashkisë. Plotësimi i organikës së kësaj qendre si dhe investimet janë kompetencë e saj.
- **Për rekomandimin e dytë.** Ky shërbim tenderohet nga vetë institucioni sipas nevojave me fonde të akorduara nga buxheti dhe drejtori ka të gjithë kompetencat ligjore për ta planifikuar si shërbim nëse është i nevojshë për qendrën
- **Për rekomandimin e tretë.** Përfshirja e shoferit është në kundërshtim me VKM-në nr.1139 datë 24.11.2009 “Për përcaktimin e numrit të automjeteve dhe të shoferëve në dispozicion të Ministrive dhe institucioneve qendrore”. Si rrjedhojë edhe vendosja e automjetit është e pamundur.

Ndërsa nga ana e Bashkisë Gjirokastrë, me shkresën nr.2317/1 datë 22.04.2016, na u kthye përgjigja e mëposhtme:

- **Për rekomandimin e parë dhe të dytë.** Organika e Shtëpisë së të Moshuarve Gjirokastrë është miratuar me VKM nr.88 datë 25.10.2010. për vitin 2016 nuk ka mundësi financiare për të përballuar shtimin në organikë me psikolog, mjek me kohë të plotë dhe roje objekti. Kjo qendër ka mjek me kohë të pjesshme. Shërbimi me roje objekti tenderohet nga vetë institucioni.
- **Për rekomandimin e tretë.** Pavarësisht se shtimi në organikë me një shofer bie në kundërshtim me VKM nr.1139 datë 24.11.2009, Bashkia Gjirokastrë ka vendosur në dispozicion të Shtëpisë së të Moshuarve një prej automjeteve të saj, për ta përdorur kur është e nevojshme.
- **Për rekomandimin e katërt.** Për vendosjen e ngrohjes qendrore Bashkia Gjirokastrë nuk ka mundësi financiare gjatë vitit 2016. Mendohet ta vendosin në planifikimin e buxhetit për vitin 2017.

Nga takimi me Drejtuesin e Shtëpisë së të Moshuarve Gjirokastrë, me punonjësen sociale dhe shërbëtorin e financës, konstatuam se rekomandimi :

1. Për shtimin në organikë me psikolog, mjek me kohë të plotë, nuk ishte realizuar.

2. *Për shtim në organikë me roje objekti, ishte realizuar nga vetë institucioni. Brenda organikës së institucionit, detyrën e rojes së objektit e kryente një kujdestar gjatë orëve të natës.*
3. *Për vendosjen e një automjeti, ishte realizuar. Automjeti është vendosur nga Bashkia Gjirokastër. Punonjësi, i cili sipas organikës është me detyrë “mirëmbajtës”, kryente edhe detyrën e shoferit.*
4. *Për funksionimin e ngrohjes qendrore, nuk është realizuar.*

Nga inspektimi i kryer rezultoi si më poshtë:

Në këtë qendër strehohen të moshuar duke filluar që nga moshën 60 vjeç. Aktualisht strehoheshin 50 të moshuar, nga 55 që është kapaciteti i kësaj qendre. 10 të moshuar janë të sëmurë me prapambetje mendore e të sëmurë paraplegjikë e tetraplegjikë.

Personeli i kësaj qendre përbëhet nga 21 punonjës, ku të gjithë ishin të kualifikuar sipas pozicionit përkatës.

Me problemet psiko-sociale merrej vetëm një punonjëse sociale. Bashkia Gjirokatër ka shtuar në këtë institucion një “sanitare”, ndërkohë që 9 (nëntë) janë në organikën e tij.

Të gjitha shërbimet mjekësore realizohen nga mjeku, i cili punon me kohë të pjesshme. Vizitat dentare kryhen në klinika private me shpenzimet e të moshuarve, por edhe nga institucioni.

Plani individual për çdo të moshuar mbahet nga mjekja dhe kryekujdestarja. Çdo i moshuar ka kartelën e tij mjekësore.

Dosjet personale të punonjësve të kësaj qendre mbaheshin në institucion. Përshkrimi i punës për personelin pasqyrohet në Rregulloren e Brendshme e Shtëpisë së të Moshuarve Gjirokastër, e miratuar nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Gjirokastër.

Drejtuesi i këtij institucioni u shpreh se stafi është trajnuar nga Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim me Bashkinë Gjirokastër.

Kuota ushqimore është ende në nivelin e 320 lekëve në muaj për çdo person që trajtohet në qendër. Ka një komision multidisiplinor, i cili përbëhet nga: të moshuar, kujdestarët, punonjësja sociale dhe kuzhinierja, të cilët përcaktojnë menynë javore. Menyja ditore miratohet nga Drejtori i institucionit.

Siç e kemi theksuar edhe në korrespondencat e mëparshme, ambjentet e kësaj Shtëpie të Moshuarish janë në kushte shumë të mira, ku mbizotëron pastërtia.

Ishte kryer rikonstrukcioni i lavanderisë, veshje pallkash e rregullim të dusheve. Duke qenë se organizohen aktivitete të ndryshme, me qëllim për një shfrytëzim sa më efektiv të ambjenteve, ishte realizuar bashkimi i ambjentit të hollit, ku rrinin të moshuarit me mencën, me anë të një ndarje duralumini në formë fizarmonike.

Në ambjente të veçanta ishin të afishuara rregullorja e brendshme, standartet që duhet të respektonin punonjësit e qendres dhe të përfituesve. Kutia e ankesave, çelësi i së cilës mbahet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror në Gjirokastër, hapet në datë 1 (një) të çdo muaji, në prani të Drejtorit të institucionit dhe punonjësit social.

Mjetet për shmangjen e rreziqeve që mund të vijnë nga rastet e emergjencave civile, ishin të vendosura në një kënd të caktuar dhe stafi ishte i trajnuar.

Organizoheshin vazhdimisht aktivitete të ndryshme, rite fetare, eksursione të ndryshme, festa fetare apo zyrtare, ditëlindje, etj. Organizata fetare "Nehemia", me qendër në Pogradec shkonte çdo javë, çdo ditë premtë.

Monitorimi i standarteve për përfituesit kryhej 3-4 herë në muaj nga inspektorë të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, çdo muaj nga Drejtoria e Higjienës dhe ajo e Ushqimit. Nuk është kryer asnjë monitorim nga Bashkia Gjirokastrë.

Të moshuarit në këtë institucion vijnë nga qytete të ndryshme të Shqipërisë dhe vizitohen shpesh nga të afërmit e tyre.

Gjatë komunikimit me të moshuarit, ata shprehën përkushtimin e stafit dhe të Drejtuesit të këtij institucioni si dhe ishin shumë të kënaqur nga kushtet dhe trajtimi i tyre.

Gjatë këtij inspektimi, u konstatuan edhe problematikat e mëposhtme:

- Në këtë Shtëpi të Moshuarish strehohen 10 të moshuar me probleme të rënda shëndetësore, prapambejtje mendore, gjë që krijon shumë shqetësim tek të moshuarit e tjerë.
- Në organikën e punonjësve të institucionit nuk ka psikolog, i domosdoshëm të jetë i pranishëm për këto kategori përfituesish.
- Kuota ditore ushqimore për çdo të moshuar në vlerën e 320 lekëve, sipas Drejtuesit të këtij institucioni, nuk është e mjaftueshme. Aktualisht, me rritjen e çmimeve të mallrave ushqimore, me qëllim zgjedhjen cilësore të produkteve, kërkohet rritje e vlerës së kuotës ditore, nga 320 lekë minimalisht në 350 lekë në muaj.
- Aktualisht ngrohja realizohej me rezistenca në çdo dhomë. Siç e kemi shprehur edhe më parë, problematika në këtë rast konsiston jo vetëm në shpenzimet për energjinë elektrike pasi ka 25 dhoma, por më e rëndësishme është mundësia e rrezikut për jetën e të moshuarve. Kjo për faktin se ata janë me sklerozë e me sëmundje të tjera dhe mund të sjellin pasoja të rrezikshme për to.
- Një problem që vijon të mbetet shqetësues është edhe ajo e mjekut me kohë të pjesshme, pasi të moshuarit janë me probleme shëndetësore të ndryshme dhe kanë nevojë që mjeku të jetë tërë kohës i pranishëm në qendër.

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*", në kuadrin e decentralizimit të shërbimeve shoqërore, po ju drejtohem me rekomandime si Bashkisë Gjirokastrë ashtu dhe Shërbimit Social Shtetëror, për një bashkërendim të punës, me qëllim ofrimin e një shërbimi sa më cilësor dhe për të realizuar standartet e shërbimeve për një jetesë me dinjitet të këtyre përfituesve.

Sa më lart,

REKOMANDOJMË:

-Shtimin në organikë me psikolog dhe mjek me kohë të plotë. Nga ana e Bashkisë Gjirokastrë të shihet mundësia e zëvendësimit të detyrës së “sanitares” me “psikolog”.

- Bashkërendim të punës ndërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Gjirokastrë për vënien në funksionim të ngrohjes qendrore.

- Bashkërendim i punës përpara i përket planifikimit të Buxhetit dhe organikës së këtij institucioni.

-Ngritjen e një grupi pune për të grumbulluar të gjithë personat me probleme psikike në një qendër zhvillimi.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se, *“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”*,

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI